



EKSTRAKT

i procesverbalit të mbledhjes nga diskutimi publik me qytetarë, mbajtur më 13.04.2023, duke filluar në orën 12:00.

Në diskutim morën pjesë: Osman Bllaca, Artan Mullarama, Naser Gashi, Sylë Vitia, Driton Sejdiu, Visar Zeka, Begishe Ismajli, Sadudin Hasani, Feriz Krasniqi, Engin Sylejmani, Serbeze Sylejmani, Violeta Hasani, Vesel Fejzullahu, Arbnore Berisha, Gëzim Sveçla, Ermal Osmani, Petrit Reçica, Ajrulla Emini, Arben Zhjeqi, Jahë Balaj, Arber Xhigolli, Xhevrije Peci, Florian Krasniqi, Lirian Hasani, Adnan Krasniqi, Burim Hasimi, Murat Vitija, Beg Hasimi, Feim Osmani, Granit Prestreshi, Gëzim Mehmeti, Elmire Nikçi-Rexha, Sami Salihu, Egzon Pacolli, Gëzim Dushi, Donika Ahmetaj, Lindita Rexhepi, Bardh Kelmendi, Atdhe Ahmetaj, Jehona Ibraj, Zekë Ismajlaj, Kushtrim Mirena, Avni Haxhiu, Berkant Shala, Besim Gashi, Adem Rushiti, Isa Gashi, Arif Krasniqi, Ekrem Jakupi, Kushtrim Mushica, Shaip Dushi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Kryetari Përparim Rama, Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Sokol Havolli, kryeshef i NPL “Prishtina Parking” dhe Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Osman Bllaca**, përfaqësues i ekzekutivit, duke ju uruar të pranishmëve, mirëseardhje në takimin me qytetar.

Në vazhdim ai tha së për këtë takim është paraparë ky

REND I DITËS:

- 1. Diskutim publik lidhur me Projektregullorën për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës.**

Osman Bllaca, hapi diskutimin

Përparim Rama - kryetar, përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderoj për pjesëmarrje në këtë dabit publik.

E di se shumë nga ju keni hasur në disa probleme në përpilimin dhe zbatimin e Rregullorës paraprake dhe për këtë arsye kemi vendos që të njëjtat t'i dëgjojmë edhe nga ju, t'i rishikojmë dhe të trajtohen në mënyrën më të duhur për të gjithë ne.

Florian Dushi, drejtor lidhur me Projektregullorën për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, tha se ne si drejtori jemi ballafaquar me numër të madh të ankesave dhe kërkesave të qytetarëve që ndërlidheshin me shtrirjen ose zbatimin e projektit të "Prishtina Parking" në Kryeqytet, kështu që duke pasur parasysh gjendjen e krijuar është themeluar një grup punues i cili ka punuar mjaftë gjatë dhe ka analizuar në hollësi të gjitha aspektet e kësaj rregulloreje janë analizuar, janë vlerësuar madje edhe një pjesë e tyre janë përfshirë në këtë draft.

Janë rregulluar mjaftë shumë çështje të cilat kanë qenë të pazgjidhura me draft rregulloren, janë rregulluar mjaftë shumë çështje të cilat kanë lënë hapësirë për interpretime të ndryshme me drafte rregulloren e vjetër ose atë që është në fuqi sot.

Për veç bazës ligjore që kishte për të trajtuar ankesat e qytetarëve me Rregulloren e cila është në fuqi, ishte e autorizuar edhe të e mbikëqyrë implementimin ose shtrirjen e Ndërmarrjes "Prishtina_Parking".

Me këtë rregullore mund të vendoset rend, mund të vendoset rregull në kuptimin e menaxhimit të hapësirave të dedikuara për parkimin e veturave qoftë të banorëve rezident ose të atyre që frekuentojnë zona të ndryshme të Kryeqytetit për punët e tyre, kështu që ne mendojmë që edhe me komentet, sugjerimet dhe idetë e juaja, të cilat do të kemi mundësi t'i dëgjojmë gjatë këtyre ditëve që do të kemi edhe organizimin e këtyre debateve publike që ndërlidhen me këtë Rregullore, qoftë nga ana e qytetarëve, bizneseve apo edhe përfaqësuesve të zgjedhur të popullit që janë pjesë e Asamblesë Komonale të Prishtinës. Çmimorja për të gjitha parkingjet do të caktohet nga Kuvendi Komunal i Kryeqyteti. Menaxhimi dhe klasifikimi i zonave të vendparkimeve publike, hapësira me ngjyrë të kaltër, është e përcaktuar për banor vetëm me leje të vlefshme parkimi të cilët parapaguajnë dhe mund të parkohen në zonën me ngjyrë të kaltër, personat e tjerë mund të përdorin këto parkime vetëm deri në orën 16:00.

Si grup punues, me përfundimin e dëgjimit të debateve me qytetarë, ku do t'i trajtojmë secilën veç e veç, për të parë nëse ka hapësirë të përfshihen në këtë draft Rregullore.

Osman Bllaca, i njoftojë të gjithë të pranishmit me disa nga rregullat e këtij dabati publik.

Violeta Hasani, tha se ju përgëzoj për iniciimin e kësaj Rregulloreje sepse ka pasur nevojë për ndryshime dhe shumë nga qytetarët kemi probleme me zbatimin e Rregullores paraprake.

Ekrem Jakupi, qytetarë i lagjes "Bregu i Diellit", tha se ne si banorë konsiderojmë se kjo Rregullore është e kundërligjshme dhe antikushtetuese. Ai tha së e njëjta mund të gjejë zbatimin në disa nga pjesët e qytetit si psh te Lagjja e Spitalit, Qendra Tregtare, por jo edhe në lagje me banorë rezidentë sepse për momentin dhe kohën që jemi duke jetuar mendoj që është shumë e papërbalueshme për qytetarët.

Këto hapësira të parkingjeve që i kemi nuk janë të mjaftueshme as për banorë rezident e jo edhe për palë të treta të cilëve sipas kësaj Rregullorje ju mundësohet me ardh dhe me u parku.

Engin Sylejmani, banor i lagjes “Meto Bajraktari”, tha së ne si banorë të kësaj lagjeje kemi bërë shpesh herë kërkesa dhe peticione në Komunën e Prishtinës, pasi hapësira jonë e parkingut përdoret nga kamionë, traktorë dhe mjete të cilat e pengojnë të kemi një jetë normale në atë lagje.

Florian Krasniqi, banor i lagjes “Hajdar Dushi”, tha se problemi jonë është mosfunksionimi i “Prishtina Parkingut”, ndërsa në banorët paguajmë dhe nuk gjejmë parkingje.

Nuk jam kundër biznesve dhe kompanive të sigurimit, por jo edhe në të jemi të bllokuar gjithë kohën nga ta. Besoj se është e kuptueshme që qmimet e parkingjeve në qendër të jenë pak më të larta por jo edhe me atë që disa nga bizneset ta kalojnë ditën me 0.50 cent. Ajo së çfarë kërkojmë nga ne si lagje është vendosja e laurave si dhe të caktohet një orar i caktuar për furnizim me mallra për biznese.

Begishe Ismajli, banore nga Qendra e Prishtinës, kërkojë që të bëhet zbritja e çmimeve nga “Prishtina Parking”.

Ilirjan Hasani, tha së është kundër “Parking Prishtina”, në vende rezidente, për arsyeje sepse ashtu sikur ju që jeni nëpër shtëpi edhe ne në banesa duhet të kemi një parking para banesës dhe jo që dikush tjetër të vij për ta administruar me atë.

Ndërsa për pjesë të qendrës jam shumë për që të ketë funksionim në orar dhe qmime të parkingjeve nga “Prishtina Parking”.

Feriz Krasniqi, banor i ish lagjes “Ramiz Sadiku”, tash rruga “Jonuz Zejnullahu” tha se kërkesa jonë është për dy- tri shenja që mungojnë në rrugë, pasi që ajo lagje është rrugë qarkore, ku hyn aty edhe del, pra është lagje ekskluzivisht e banorëve.

Ajfer Xhigolli, banorë i zonës Qendra, tha sipas asaj që shihet kjo Rregullore është bazuar në Ligjin 05/L-088, nenin 33, paragrafin 1, shkronja C edhe pse e njëjta nuk egziston në ligjin e trafikut pra është e kundërligjeshme dhe shkelje e Kushtetutës. Prandaj ju kisha lutur që gjatë përpilimit të kësaj Rregulloreje të merret për bazë Rregullorja e Ministrisë së Planifikimit Hapsinorë, dhe Ligji për bashkëpronësi, të cilat ju dhënë të drejta banorëve rezidentë.

Sylë Vitia, përfaqësues i kategorive të dala nga lufta e UÇK-së, në Komunën e Prishtinës. Ai tha se bazuar në ligjin 04/L-54 neni 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.8, kërkojë që invalidët e luftës së UÇK-së, të lirohen nga pagesa, duke u përfshirë në nenin 20 të draft rregullores në këtë rast.

Duke marrë parasysh gjendjen e invalidit të luftës, vetura është e domosdoshme, andaj kërkojë që invalidët e luftës së UÇK-së, të përfshihen në Rregulloren aktuale në nenin 20, si kategori e liruar nga pagesa.

Xhevrije Peci, tha se jam person me aftësi të kufizuara dhe dua të ndërlidhem për invalidët e UÇK-së, së jemi një kategori që duhet t'i marrim të drejtat që na takojnë me ligj. Unë i kam bërë 3 kërkesa në komunë dhe nuk kam marrë asnjëherë përgjigje, kam shkuar në Shërbime Publike dhe pastaj edhe te Prishtina Parking, atje më është kërkuar pagesa prej 70 euro për një vitë edhe pse të gjitha dokumentet i kam në rregull. Ajo po ashtu theksojë që disa nga nenet e kësaj Rregullorje, duhet të ndryshohen psh. Neni 20, pika 1.3 personat me aftësi të kufizuara të cilët janë nën përcjellje të personit shoqërues, keni bërë diskriminim total, sepse invalidi i luftës ndoshta e ka këmbën por ai mundet vetë, mirëpo ai është me një aftësi të kufizuar. Ajo shtoj se për këtë pjesë të kategorisë automjeti është mjeti ndihmës që mundemi të kryejmë punë si sot të vijë në Komunë, me e ngrit zërin, të shkoj në ortopedi për t'i kryer ushtrimet, ose për nevoja elementare.

Përparim Rama - Kryetar, tha se i falënderon edhe njëherë për takimin e sotëm dhe së të gjitha kërkesat e qytetarëve do të merren parasysh në implementimin e kësaj Rregullore. Por edhe pas miratimit të saj nuk do të thotë që nuk do të kemi prapë takime të përbashkëta dhe të kemi ndryshime në përmasimin e vazhdueshëm të jetës së qytetarëve. Sa i përket pyetjes që më bëri zonja për Britaninë, ka zona të ndryshme që janë të dedikuara për persona me aftësi të kufizuara por të gjitha janë në varësi me zonën, kohën dhe arsyjen se për çfarë parkohesh. Ai tha se duhet ta krijojmë rregulloren e cila nuk lejon lëshime për keqpërdorime, kjo është e gjithë ideja që "Prishtina Parking", ta krijoj një sistem një rregull në të gjithë kryeqytetin ku banorëve ju lehtësohet jeta. Për këtë arsye edhe "Prishtina Parking", është krijuar, për ta lehtësuar jo përkeqësuar jetën e qytetarëve të Prishtinës.

Xhevrije Peci, tha se nga përgjigja që kam marr nga "Prishtina Parking", është së t'i mundesh me marr vendin me e sinjalizuar, me bërë pagesn vet dhe me e vendosë tabelën që je person me aftësi të kufizuara. Por nuk janë kushtet e njëjta për të gjithë për të vepruar në këtë mënyrë dhe se sipas rregulloreve dhe ligjeve të aprovuara më herët ne jemi të liruar nga këto taksa. Ajo kërkojë që kartela e personave me aftësi të kufizuara me u vendosë kudo që kemi institucione.

Naser Gashi, qytetar i "Kodrës së Diellit", tha se problemi i tij kryesor mbetet lirimi i trotuareve në dy rrugët "Isë Kastrati" dhe rruga nga varri i Rugovës. Ndërsa sa i përket Rregullores në fjalë tha se çmimi i parkingjeve duhet të jetë i arsyshëm për qytetarët.

Arben Zhjeqi, qytetar i rrugës “Rexhep Luci”, tha se pjesa ku ai jeton është një katrahurë e vërtetë. Pas vendosjes së “Prishtina Parkingut”, jemi pak më mir por prap se prap kemi probleme për shkak të mungesës së parkingjeve. Ai tha se është kundër laurave dhe mendon së zgjidhja më e mirë do të ishte që prej tunelit deri në pjesën tek kinemaja të bëhet shesh dhe banorët të kalojnë nga ana tjetër, pasi që ajo pjesë nuk ka hapsira për vizitorë.

Hajrullah Emini, qytetar i lagjes “Kodra e Diellit”, rruga “Qamil Bala”, tha se problem nuk është “Prishtina Parking”, por problemi egziston tek rregullorja, pasi që sipa kësaj rregulloreje parkingjet e banorëve rezident i ka shpallur si territore publike dhe të gjithë pa dallim mund të vinë të parkohen aty.

Pajtohem që duhet “Prishtina Parking”, me vendos rregull ku duhet të parkohet, ku të vendosen vijat, por jo t’i marrin 50 euro dhe kur të kthehem në shtëpi të mos kem vend për ta parkuar makinën.

Zeke Islamaj, banore e lagjes “Kodra e Diellit”, tha se ne paguajmë taksë për vetura, e cila është diku 10 euro. Ajo tha se në pjesën ku jeton përveç trotuarit edhe rruga është përdorur për parking, dhe së aty është një laurë jashtë përdorimit dhe që askush nuk ndërmerr masa për këtë.

Jahë Balaj, tha se rregullorja paraprake ka pasur shkelje ligjore dhe pse e keni zbatuar dhe vazhdoni ta zbatoni kundër qytetareve që ju kanë zgjedhur juve. Kjo Rregullore në asnjë nen të saj nuk i ndihmon qytetarit dhe së i pengon banorët për të e vijuar jetën normalisht. Në lagjen “Lakërishtë”, nuk ka asgjë, pra nga çerdhja, shkolla fillore, prej policisë, prej ambulancës asgjë nuk kemi, nuk kemi as bashkësisë lokale etj. Kërkojmë nga kryetari që vërejtjet tona të i merr parasysht sidomos për banorët rezident.

Atdhe Ahmetaj, tha se ekzekutivi i Komunës duhet të mendoj mirë për qytetarët e Prishtinës, së pa këta qytetar Prishtina nuk ka kuptim sigurisht. Shpresoj që edhe praktikrat e kaluara nga ndërmarrja “Prishtina Parking”, e cila ka vepruar duke frikësuar njerëzit nën syrin edhe nën petkun e shtetit.

Është për të ardhur keq, shpresoj që të merreni këtë parasysht dhe t’i merrni parasysht shqetësimet tona si banor rezident të Prishtinës.

Gëzim Sveçla, qytetar, dhe në cilësinë e anëtarit të Kuvendit tha se kjo rregullore duhet të jetë sa më e përshtatshme dhe e zbatueshme në praktikë.

“Prishtina Parking”, është shumë e nevojshme për kryeqytetin por “Prishtina Parking”, sipas mendimit tim edhe një pjese të Kuvendit Komunal të cilën e përfaqësoj, nuk mundet të veprojë në zonat ku kemi të bëjmë me bashkëpronësi të banorëve dhe është shumë e rëndësishme me e ditë cili është qëllimi i formimit të kësaj ndërmarrje.

Edhe me rregulloren e re të propozuar, ky shërbim ndaj qytetareve është i limituar e në shumë vende edhe i penalizon ata, e sidomos qytetarët e Prishtinës, ku disa prej neneve të saj bien në kundërshtim me ligjin.

Mendoj se edhe mënyra e pagesës për rezervim të parkingut si dhe për shumë çështje tjera nuk qëndrojnë, kështu për këtë draft rregullore kemi shumë vërejtje të cilat duhet të korrigjohen ato.

Nëse kalon edhe nëse arrini shumicën për të kaluar në këtë formë, në asnjë mënyrë nuk e kalon ligjshmërinë.

Nëse kjo nuk e kalon ligjshmërinë atëherë mbetet në fuqi rregullorja aktuale, e cila siç e thash në fillim, nuk e di qysh e ka kaluar ligjshmërinë por me të vërtetë është skandaloze.

Po ashtu banorët e lagjes “Bregu i Diellit”, po kërkojnë në një farë mënyre leje nga Komuna për tu vetorganizuar, por ata nuk kanë nevojë për leje, pasi që kjo është e rregulluar me Ligjin për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi veç e bëjnë projektin dhe e paraqesin para Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Driton Sejdiu, banor në rrugën “Fadil Ferati”, lagja “Bregu i Diellit”, tha se si ka mundur kjo rregullore me ardhur me aq pak ndryshime prej rregullores së parë, nuk janë bërë ndryshime rrënjësore. Ne si banorë të kësaj lagje pse duhet me e paguar venparkingun.

Do të ishte mirë që si bazë të i keni edhe rregulloret e disa qyteteve të rajonit, si ajo e Tiranës, Shkupit, Zagrebit etj, si dhe në çka do të bazohen anëtarët e Kuvendit për ta caktuar çmimin.

Gëzim Mehmeti, qytetar dhe në cilësinë e anëtarit të Kuvendit tha se i falënderoj qytetarët e Prishtinës, me ankesat sugjerimet të cilat i kanë dhënë po ashtu besoj që ekzekutivi dinë të i merr parasysht për arsye nëse këto ankesa legjitime për të drejta nuk merren parasysht dhe ne vetëm një rregullore e formulojmë në fakt këto ndryshime atëherë nuk kemi qenë në shërbim të qytetit të Prishtinës.

Po ashtu kisha sugjeruar që për veturat zyrtare dhe ato diplomatike pagesa të bëhet vetëm për 3 orë e jo të jetë pa pagesë, sepse mos të diskriminohen qytetarët e Prishtinës.

Besnik Vitija, qytetar tha se kisha kërkuar që, banorët rezident të lirohen nga pagesa, si dhe mënyra e së si po e shtrinë veprimtarinë kjo ndërmarrje duke shqiptuar gjoba, duke i detyruar banorët dhunshëm t’i nënshtrohen kontratës me “Prishtina Parkingun”, kjo nuk është e drejtë aspak.

Sabedin Hasani, qytetar, njëherit edhe në cilësinë e kryetarit të BL “Qendra” kjo ndërmarrje e ka shtrirë veprimtarinë e vet në zonën “Qendër”, sa po kanë filluar ankesat e një pjesë të banoreve dhe ne si banorë kemi bërë ankesë në Ministrinë e Pushtetit Lokal, e ata na kanë thënë ajo është kompani e re që është formuar dhe veprimtarinë e vet e ushtron në bazë të një rregullore dhe ajo rregullore e ka kaluar ligjshmërinë dhe nuk ka asgjë të pa ligjshëm.

Veton Isufaj, qytetar nga “Kurrizi”, lagja “Dardania”, tha se ne aty nuk po kemi hapësirë të mjaftueshme për parking, pasi që aty është edhe shkolla fillore “Xhemail Mustafa”. Është viti i dytë që e paguaj parkingun komplet, por nuk kemi vend të rezervuar si banor rezident që jemi aty dhe për mosparking të rregullt jemi penalizuar edhe nga policia.

Jehona Ibraj, qytetare nga lagja “Vëllezërit Gërvalla”, tha se kërkojmë që të na bëhet një zgjidhje për të gjithë banorët e asaj lagje që ta kemi një hapësirë të mundshme për parkingun e veturave, pasi që aty është një vend-park i mirë, ku mendoj se do të ishte një zgjidhje e mundshme për parkimin e veturave.

Berkan Shala, banor në rrugën "Qamil Balla", lagja "Bregu i Diellit", tha se edhe ne kërkojmë që banorët rezidet të lirohemi nga pagesa për parking, pasi që kemi hapësirë për parking të veturave.

Isa Gashi, qytetar nga rruga "Vëllezërit Gërvalla" tha se do të ishte mirë që në rregullore të parashihet edhe një dispozitë, që rezervimi për lagjet rezidente mundet me u bërë vetëm me pëlqimin e 70-80% të banorëve.

Po ashtu mendoj se Komuna duhet të bëjë zgjerimin e hapësirave për parking në ato lagje ku ka mundësi zgjerimi.

Adnan Krasniqi, qytetar nga rruga "Vëllezërit Gërvalla" tha se do të ishte mirë që të jetë një vet menaxhim për secilën lagje për parkingjet e tyre.

Ajtene Xhigoli, tha se në zonën "Qendra", të sheshi "Edit Durham", banesat e Avallës, të gjitha ato nuk kanë mundësi për të paguar, pasi që shumica janë biznese, kështu që do të jetë problem i madh vendparkimi për vetura.

Kisha sugjeruar që kur të hartohet kjo rregullore dhe të bazohet në ligje dhe nëse nuk ka për bazë ligjet, mendoj se kjo rregullore do të jetë e kundërligjshme.

Naser Gashi, qytetar tha se do të ishte mirë që të gjitha këto paqartësi rreth parkingjeve të rregullohen në bazë të rregullores por paraprakisht ekzekutivi duhet t'i kenë parasysh çmimet për disa zona të caktuara.

Beg Hasimi, qytetar nga rruga "Vëllezërit Gërvalla" tha se jemi mbi 90% kundër "Prishtina Parking", në lagjen tonë, pasi që ne jemi banor rezident prej vitit 1977, kur i kemi marrë banesat, i kemi marrë me infrastrukturë të plotë, me parkingje, me gjelbërim, kështu që është edhe kërkesë themelore që nga aty të hiqet edhe laura e cila neve na pengon shumë për të u kyçur në rrugë.

Ne mbi 90% të banorëve jemi kundër, i kemi parkingjet e siguruara dhe i menaxhojmë vet.

Violeta Hasani, qytetare, zona "Qendër", tha se nëse shumica e banorëve janë pro shtrirjes së parkingut, besoj së parkingu ka me hyrë në lagje, dhe s'ka me pas kush me ndalë, por nëse janë kundër, atëherë ka për tu respektuar vendimi ashtu siç e potencoi edhe kryetari, se pa pëlqimin e banorëve nuk do të ketë parking.

Po besoj që kjo rregullore do të hartohet në bazë të ligjeve, në mënyrë që mos të na kthehet pastaj e paligjshme e të vazhdohet prapë me rregulloren e vjetër.

Vesel Fejzullahu, banor nga lagja "Rexhep Luci", "Qendra", kërkoi që për këtë zonë të jetë një tretmanë shumë më i veçantë, për shkak se aty e kemi KEK-un, e kemi Policinë, regjistrimin e veturave, kemi me qindra lokale, prandaj të gjitha këto e bëjnë shumë të komplikuar "Qendrën".

Kërkoj që qasja për në këtë parking të bëhet përmes ish- rrugës e cila ka qenë aty, pasi që qasja përmes tunelit paraqet rrezik për banorët e asaj zone, si dhe kërkoi që të lirohen

dyert e hyrjes, pasi që ajo hapësirë është ngushtuar prej atyre lokaleve që merren me biznese të ndryshme.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Kryetari Përparim Rama, dhe Kryeshefi Ekzekutiv Sokol Havolli,.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Diskutim publik, lidhur me Projektregulloren për organizimin dhe
shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës
13 Prill, 2023

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	ARTAN	MULLARAMA	NPL PP		
2	NASER	GASHI	Qytetar		
3	Syle	VITIA	SHKQIMAT CUSK		
4	Dauton	Sejdin	Qytetar		
5	Visar	ZEKA	Qytetar		
6	Albi	Albi			
7	Begishe	ISMALI	QENDRA		
8	Sadudin	Hasani	QENDËR		
9	Feriz	Krasniqi	Pejton		
10	Enxhin	Sufelmani	Qytetar		

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	SERBEZE	SYLEJIMI	QYTETARE		
12	VIOLETA	HASANI	KLST-Grude		
13	VESEL FERULLI	Ferullit	Qytetar		
14	Almira Basha	Bashaj	Asambleiste		
15	Gëzim	Sueqja	— II —		
16	Ermal	Osmani	— II —		
17	PETRIT	REGICA	ASAMBLEIST		
18	Shkëlqim	Emine	Përvashur me Reg. G e Qytetare në Prizren		
19	ARDE	ZHIGRI	Qytetar		
20	JANE	BALAJ	QYTETAR		
21	Arif	Xhupull	Qytetar		
22	Xhëdije	Peu	QYTETARE		
23	Fioran	KRASNIC	QYTETARË		
24	LIRAN	HASANI	QYTETARE		
25	ARMAN	KRASNIC	B. DILLI		
26	BURIM	HASIMI	BANOR REZIDENT		
27	MURAT	VITIJA	BANOR REZIDENT		
28	BEG	HASIMI	BANOR REZIDENT		

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
29	Feim	OSMANI	Asambleist		
30	GRANIT	PRESTRESHI			
31	BESIM	MEHMETI	Asambleist		
32	Elvire	dhëqsi - Rexha	Asambleiste		
33	SAMI	SALIU	ASAMBLEIST/ASIANA		
34	Gazon	Pacoli	Zyrtarë		
35	BESIM	DUSHI	Zyrtarë		
36	Donika	Almetaj	Shqëri Civile		
37	LINDITA	REXHEPI	ASAMBLEISTE		
38	PAJDA	KELMENDI			
39	ADRIANA	ADRIANA			
40	Jehona	Ibroj			
41	Gege	Yllmari	Arkitekt		
42	Kustriam	Mirena	Diplomat		
43	AVNI	HAXHI	EKONOMIST		
44	BERKANT	SHALA	EKONOMIST		
45	BESIM	GASHI	EKONOMIST		
46	Adem	RUSHI			

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
47	ISA	GARHI	Qytetar		
48	ARIF	KRASUQA	QYTETAR		
49	EKURER	JAKUP	qytetar		
50	Kushtrim	Mushica	Qytetar		
51	SHAPI	DUSHI	Qytetar		
52					
53					
54					
55					
56					
57					
58					
59					
60					
61					
62					
63					
64					

*P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!
*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!**